

Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-maj 2017

Zhvillime të tjera

- AMF heq licencën e shoqërisë “Stock International Albania” sh.a.
- Zhvillohen mbledhjet e Komiteteve të IAIS-it
- Zhvillohet takimi i 13-të i shteteve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore për Mbikëqyrjen e Sigurimeve
- Zhvillohet Seanca e 53-të Plenare e Komitetit të Ekspertëve për vlerësimin e masave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, Moneyval të Këshillit të Evropës
- Zhvillohet mbledhja e përbashkët e grupeve të punës IOPS/OECD mbi sistemet e pensioneve private
- Zhvillohet forumi ndërkombëtar i sigurimeve “Sigurimi i pronës: Sfida e sigurimit nga katastrofat natyrore”

Edukimi i Konsumatorit

- *Metamorfoza e Greqisë dhe roli i industrisë së sigurimeve – Kujdestarët e së ardhmes? Fjala e Z. Yannis Stournaras, Guvernator i Bankës së Greqisë, mbajtur gjatë Forumit të Parë mbi sigurimet organizuar nga “Ekonomisti” në Athinë, më 30 mars 2017 (Marrë me shkurtime dhe redaktime – pjesa e tretë dhe e fundit)*

Lajme Ndërkombëtare

- Bosnje-Hercegovinë
- Çeki
- Estoni
- Greqi
- Itali
- Sllovaki

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar–maj 2017

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit gjatë periudhës janar–maj 2017 kapën vlerën mbi 6.09 miliardë lekë, ose 10.98% më shumë se gjatë periudhës janar–maj 2016. Gjatë periudhës janar–maj 2017, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 455,791 me një rritje prej 17.63% krahasuar me periudhën janar–maj 2016.

Një tjetër tregues i ecurisë së tregut, dëmet e paguara bruto, në total, regjistrojnë një rritje me 59.76% në krahasim me periudhën janar–maj 2016. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me rreth 1.30 miliardë lekë, apo 55.21% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

Sigurimi i Jo-Jetës

Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 11.04% gjatë periudhës janar–maj 2017, krahasuar kjo me periudhën janar–maj 2016.

Sigurimi i detyrueshëm motorik

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 3.53 miliardë lekë gjatë periudhës janar–maj 2017, duke shënuar një rritje prej 12.11% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë periudhës raportuese përbën 57.87% të tregut të sigurimeve.

Klasa të tjera në sigurimet e Jo-Jetës

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:

- Sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme të cilat së bashku zunë 14.20% të tregut të Jo-Jetës;
- Zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë të cilat zunë 12.31% të tregut të Jo-Jetës.


Sigurimi i Jetës

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u rritën me 15.34% krahasuar me periudhën janar–maj 2016. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i përket sigurimit “Jetë debitori” e cila përbën 65.34% të sigurimit të Jetës.

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 3.53 miliardë lekë gjatë periudhës janar–maj 2017.

Ndarja e tregut të sigurimeve, janar–maj 2017

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore.



ZHVILLIME TË TJERA

AMF heq licencën e shoqërisë “Stock International Albania” sh.a.

Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, në mbledhjen e datës 19 qershor 2017, vendosi heqjen e dy licencave për shoqërinë “*Stock International Albania*” sh.a. për të vepruar si:

- i) Agjent i brokerit të licencuar të letrave me vlerë;
- ii) Shoqëri brokerimi për ushtrim veprimtarie tregtimi në tituj.

Ky vendim i Bordit të AMF-së erdhi pas ushtrimit të inspektimeve në vend pranë kësaj shoqërie dhe mospërbushjes së detyrimeve të lëna nga vendimi i mëparshëm i Bordit. Nga inspektimet e kryera në vend, që prej mesit të muajit mars 2017, AMF gjeti se shoqëria “*Stock International Albania*” sh.a., në funksionin e saj si agjent i brokerit të licencuar ka mbyllur zyrën ku zhvillonte aktivitetin, ka larguar stafin, si pasojë e vështirësive financiare të saj, nuk dispononte mjete teknike për të siguruar lidhjet mes klientëve dhe se shoqëria nuk ka raportuar pranë AMF-së pasqyrat financiare të vitit 2016 dhe ato lidhur me aktivitetin e kryer për periudhën 1 janar-31 mars 2017. Në mbledhjen e muajit maj 2017, Bordi i AMF-së vendosi marrjen e masave ndaj kësaj shoqërie dhe kërkoi sjelljen në AMF të:

- i) Informacionit në lidhje me njoftimin e të gjithë klientëve të tij mbi ndërprerjen e aktivitetit;

Vendimi i Bordit të AMF-së erdhi pas ushtrimit të inspektimeve në vend pranë kësaj shoqërie dhe mospërbushjes së detyrimeve të lëna nga vendimi i mëparshëm i Bordit.

ii) Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë dhe Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës për situatën e shoqërisë.

AMF kërkoi respektimin e të gjithë afateve dhe procedurave ligjore, me qëllim dhënien kohë shoqërisë për të njoftuar të gjithë investitorët dhe klientët e saj për mbylljen e aktivitetit. Shoqëria "Stock International Albania" sh.a. nuk i përmbushi detyrimet e saj të lëna nga vendimi i Bordit të AMF-së në muajin maj 2017. Për rrjedhojë, Bordi i AMF-së, në mbledhjen e datës 19 qershor 2017 vendosi heqjen e licencave për shoqërinë "Stock International Albania" sh.a.

Duke qenë se shoqëria "Stock International Albania" sh.a. në funksionin e saj si agjent i brokerit të licencuar të letrave me vlerë, nuk i kontaktoi investitorët e saj, njoftojmë investitorët se pozicionet dhe llogaritë e tyre janë drejtpërdrejtë te kompania "LeadCapital Markets" Ltd., e cila është përgjegjëse për çdo sqarim të investitorëve <http://www.leadcapitalmarkets.com/contact.php>

AMF thekson edhe një herë se investimi në platformat online është një aktivitet i cili kërkon një shkallë të lartë të informacionit ekonomik dhe kulturës financiare. Investimi në platforma të tilla mbart me vete, krahas avantazheve të fitimit, edhe rrezikun e humbjes nga këto investime, prandaj investitorët duhet të jenë të ndërgjegjshëm për to dhe të marrin përgjegjësinë e investimeve. Në faqen zyrtare online, AMF ka të listuar gjithë subjektet e licencuara për të kryer veprimtari në tregtimin e titujve, letrave me vlerë. AMF i fton investitorët potencialë dhe qytetarët të konsultojnë këtë faqe online për të marrë gjithë informacionin e nevojshëm dhe për t'u siguruar për investimin e tyre. AMF po realizon një projekt të mbështetur me Sekretariatit e Shtetit Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO), i cili do të mbështesë AMF-në në rritjen e kapaciteteve të tij për mbikëqyrjen e tregut të fondeve të investimeve dhe tregut të obligacioneve.

Zhvillohen mbledhjet e Komiteteve të IAIS-it

Në datat 26-30 qershor, në Londër, Angli, u zhvilluan mbledhjet e Komiteteve të IAIS-it Organizatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve në Sigurime (*International Association of Insurance Supervisors*). Krahas këtyre mbledhjeve u zhvillua edhe Seminari Ndërkombëtar i IAIS-it (*IAIS Global Seminar*). AMF, si anëtare me të drejta të plota e kësaj organizate, mori pjesë në këto takime.

Takimet përfshijnë mbledhjet e rregullta të të gjithë komiteteve, nënkomiteteve dhe grupeve të punës së IAIS-it si: Komiteti Teknik dhe Ekzekutiv, Komiteti i Zbatimit, Grupi i Punës së Sigurimeve, Komiteti i Stabilitetit Financiar, Nënkomiteti i Edukimit, etj.

Në Komitetin e Zbatimit, anëtar i së cilit është edhe Nëndrejtori Ekzekutiv i AMF-së, disa nga temat kryesore që u diskutuan ishin:

—○○○—
Takimet përfshijnë mbledhjet e rregullta të të gjithë komiteteve, nënkomiteteve dhe grupeve të punës së IAIS-it.

—○○○—

- Strategjia e tregjeve të reja (*emerging market strategy*);
- Rezultatet e anketimit mbi Rreziqet dhe Tendencat Kryesore në
- Sigurime (KIRT);
- Raportimet lidhur me mundësinë e përfshirjes në iniciativat e sigurimeve.

Gjithashtu, në mbledhjen e këtij Komiteti, u diskutua edhe për Forumin mbi Sigurimin e Qëndrueshëm, rezultatet e anketimit për ndërtimin e kapaciteteve mbikëqyrëse të autoriteteve në sigurime. Gjithashtu, kryetari i grupit bëri edhe një prezantim të roadmap për vitin 2018.

Në mbledhjet e komiteteve të tjera u diskutua edhe se cilat mund të jenë zonat kryesore prioritare për vitin 2018, u raportua nga puna e kryer e grupit të punës për Vlerësimin e Rrezikut Sistemik (*Systemic Risk Assessment Task Force, SRATF*), si edhe u diskutua për vëmendjen që duhet pasur ndaj rrezikut të sulmeve kibernetike.

Zhvillohet takimi i 13-të i shteteve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore për Mbikëqyrjen e Sigurimeve

Banka Kombëtare e Sllovenisë zhvilloi në datat 8–9 qershor në Bratislavë takimin e shteteve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Jug-Lindore (*CESEE*) për Mbikëqyrjen e Sigurimeve. Në këtë takim merrnin pjesë përfaqësues të autoriteteve mbikëqyrëse IAIS-it dhe bankave qendrore nga vende të ndryshme si Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Bosnje-Hercegovina, Kroacia, Serbia, Çekia, Sllovakia, Sllovenia, Hungaria, Rumania, Austria, Lituania, dhe Polonia.

Ndër çështjet kryesore të diskutuara gjatë këtij takimi ishin si më poshtë:

- Rregullimi i shpërblimeve në tregun e sigurimeve – moderuar nga Z. Stefan Velcicky, Z. Matus Medvec dhe Znj. Zuzana Turcanova të Bankës Kombëtare Sllovaqe. Gjatë këtij prezantimi u paraqit situata aktuale lidhur me komisionet e ndërmjetësve në sigurime, kryesisht në sigurimin e Jetës, produktet e lidhura me skemat e investimeve (*unit-linked*), si dhe shpërblimet në shoqëritë e sigurimit. Gjithashtu u përmendën problematikat në produktet e skemave të investimeve, të cilat nuk janë të ndara në produkte afatgjatë dhe si të tilla mund të mos kenë investime në periudhat fillestare. Disa nga mundësitë e përmendura për zgjidhjen e kësaj problematike ishin: vendosja e një tavani për komisionin si % e primit vjetor; ndarja e komisionit në disa këste; si dhe vendosja e % minimale të primit që do investohet në 3 vitet e para.

Përsa i përket shoqërive të sigurimit, problematika e komisioneve dhe shpërblimeve është adresuar në regjimin *Solvency II*, që pritet të zbatohet nga gjithë shtetet e BE-së.

Përsa i përket shoqërive të sigurimit, problematika e komisioneve dhe shpërblimeve është adresuar në regjimin *Solvency II*, që pritet të zbatohet nga gjithë shtetet e BE-së.

- Direktiva e distribucionit në sigurime (*IDD – Insurance Distribution Directive*) - moderuar nga Z. Peter Braumuller, Drejtor Ekzekutiv në FMA, autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit dhe fondeve të pensionit në Austri; Kjo direktivë ka hyrë në fuqi në 22 shkurt 2016, duke amenduar direktivën e ndërmjetësve në sigurime (*Insurance mediation directive, IMD*) të vitit 2002. Kjo direktivë, ashtu si edhe direktiva e mëparshme, ka si qëllim harmonizimin minimal duke i lënë dorë shteteve të BE-së të vendosin kërkesa të tjera, më të ashpra, në mënyrë që të mbrojnë konsumatorët. Pjesëmarrësit në këto takime komentuan mbi fazën në të cilën ndodhet miratimi i kësaj direktive apo vështirësitë që po hasen gjatë këtij procesi. Për disa nga vendet pjesëmarrëse, si p.sh. Kroacia, zbatimi praktik i kësaj direktive duket i vështirë, ndërsa për vende si Lituania ky proces ka filluar dhe direktiva është shpërndarë tek palët e interesit për mendim. Për Austrinë, draftligji mbi direktivën e distribucionit në sigurime, *IDD* pritet të miratohet në korrik 2017.
- Strategjia e IAIS për tregjet në zhvillim – Diskutim mbi rishikimet e Strukturës së Zbatimit të koordinuar dhe përmirësimit të aktiviteteve të vlerësimit të IAIS – moderuar nga Z. Conor Donaldson, Menaxher i Zbatimit, Sekretariati i IAIS. Në prezantimin e tij, Z. Donaldson, theksoi rolin e IAIS dhe strategjinë e ndjekur prej tij për tregjet në zhvillim, si dhe rishikimin e strukturës së zbatimit dhe përmirësimit të aktiviteteve të vlerësimit të IAIS.
- Modeli i biznesit B2B2C, problematikat e tij dhe mbrojtja e të drejtave dhe interesit të konsumatorëve, përfshirë këtu edhe aspekte të shpërndarjes – moderuar nga Znj. Zuzana Filipova, Kryetare e Njësisë së Inspektimeve në Sigurime, në Bankën Kombëtare të Çekisë
- Disa nga problematikat e ngritura në këtë prezantim kishin të bënin me mungesën e eksperiencës së mbikëqyrësve për këtë lloj produkti, të drejtat dhe detyrimet e konsumatorit dhe shoqërisë së sigurimit, si dhe fuqinë e mbikëqyrjes dhe ndryshimet ligjore për të përfshirë modelin e B2B2C në sigurime.

○○○

Pjesëmarrja në këtë seancë ishte e rëndësishme për delegacionin shqiptar pasi në datat 2-14 tetor 2017, do të kryhet vlerësimi i masave që ka marrë Shqipëria.

Zhvillohet Seanca e 53-të Plenare e Komitetit të Ekspertëve për vlerësimin e masave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, Moneyval të Këshillit të Evropës

Në datat 30 maj-1 qershor 2017 u zhvillua në Strasburg, Francë, seanca e 53-të Plenare e Komitetit të Ekspertëve për vlerësimin e masave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, Moneyval të Këshillit të Evropës, në të cilën delegacioni shqiptar përbëhej nga ekspertë të

Bankës së Shqipërisë, Prokurorisë së Përgjithshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP), Policisë së Shtetit, Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) dhe Ministrisë së Drejtësisë.

Pjesëmarrja në këtë seancë ishte e rëndësishme për delegacionin shqiptar pasi në datat 2-14 tetor 2017, do të kryhet vlerësimi i masave që ka marrë Shqipëria.

Ndër çështjet që u diskutuan gjatë kësaj seance, përmenden:

- Raporti i vlerësimit për Slloveninë;
- Raporti i Malit të Zi, të cilit iu la si detyrë përgatitja e një raporti më të zgjeruar për tu diskutuar në seancën e 54 Plenare (26-28 shtator 2017);
- Raporti i Bullgarisë, Lituaniës, Polonisë dhe Republikës Çeke.

Gjatë seancës u prezantuan dy materiale lidhur me kërcënimin dhe format e reja të financimit të terrorizmit në kuadër të sulmeve të fundit terroriste, si dhe financimet që rrjedhin nga skllavëria, trafikimi i qenieve njerëzore, puna e detyrueshme e fëmijëve. Gjithashtu, u shkëmbyen mendime lidhur me dimensionin gjinor të pastrimit të parave.

Në takime u diskutuan *Paper-at* e përgatitura nga grupet e ndryshme të punës mbi ndikimin e nxitjeve fiskale tek kursimet për pension, aftësinë paguese të skemave të pensionit me përfitime të përcaktuara, si dhe roli i aktuarëve në përcaktimin e normave të skontimit.

Zhvillohet mbledhja e përbashkët e grupeve të punës IOPS/OECD mbi sistemet e pensioneve private

Në datat 19-21 qershor 2017 Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) zhvilloi në Paris, Francë, mbledhjen e përbashkët IOPS/OECD të Grupeve të Punës mbi Pensionet Private, si dhe seminarin kërkimor të rrjetit ndërkombëtar për kërkimin në fushën e pensioneve (*INPARR-International Network for Pensions, Aging, and Retirement Research*). Të pranishëm në këto takime ishin përfaqësues të autoriteteve mbikëqyrëse të fondeve të pensionit nga të gjitha vendet anëtare të OECD dhe IOPS.

Grupet e punës të ngritura për kërkimin mbi tematika të ndryshme në fushën e pensioneve përbëhen nga vende të ndryshme anëtare të OECD apo IOPS dhe drejtohen nga një shtet i caktuar si Leader i projektit kërkimor. Kështu u diskutuan *Paper-at* e përgatitura nga grupet e ndryshme të punës mbi ndikimin e nxitjeve fiskale tek kursimet për pension, aftësinë paguese të skemave të pensionit me përfitime të përcaktuara, si dhe roli i aktuarëve në përcaktimin e normave të skontimit.

Diskutimet në takime lidheshin me:

- Ndikimin e zhvillimeve teknologjike në kursimet për pension. Fokus i diskutimit ishin këshillimet për investimet për pension nëpërmjet kompjuterit (*Robo Advice*) përparësitë që mund të sjellë dhe riskun e

shitjeve të gabuara. Gjithashtu u trajtua edhe çështja e aftësisë së rregullatorëve dhe mbikëqyrësve për t'iu përgjigjur platformës *Robo Advice*;

- Rezultatet e një punimi tematik;
- Edukimin financiar dhe rëndësinë e tij në hartimin e skemave me kontribute të përcaktuara (*Defined Contributions*);
- Aktivitetet e huadhënies të kompanive të fondeve të pensionit, ku u diskutua kuadri rregullator lidhur me aktivitetin e huadhënies, limitet e përcaktuara për huadhënie, si dhe ndikimi i aktivitetit të huadhënies tek aftësia paguese e kompanive menaxhuese të fondit të pensionit; Prezantimin e sistemeve të pensionit të disa shteteve, si Kili, Indi, Islandë. Gjithashtu u prezantuan edhe rezultatet e një *stress-test* të fondeve të pensionit në Rusi;
- Kostot e menaxhimit të fondeve të pensionit, limitet e kostove, si dhe politikat dhe masat për reduktimin e tyre dhe rritjen e konkurrencës; Mbikëqyrjen e menaxhimit të investimeve, ku u diskutuan format e ndryshme të investimit të aseteve sidomos përse i përket investimeve jo tradicionale në pasuri të patundshme; Rolin e mbikëqyrjes lidhur me mbrojtjen konsumatore në sistemin e pensioneve private, ku u prezantuan praktikatat më të mira të mbrojtjes konsumatore;
- Rishikimin e parimeve të IOPS mbi pensionet private. Ndryshimet në disa prej parimeve do shërbejnë për një menaxhim më të mirë të riskut të tregut. Çështje të tjera të lidhura me strategjitë e portofolit të investimeve, kërkesat për transparencë, mbikëqyrja e zhvillimeve të reja teknologjike, si dhe financimi i autoriteteve mbikëqyrëse të pensionit, ku u diskutua mbi metodat e financimit, si duhet bërë monitorimi, si dhe si këto autoritete të vazhdojnë të mbeten eficientë në rast se disa shërbime të tyre kalojnë në outsourcing.

Gjatë seminarit ndërkombëtar kërkimor INPARR u diskutua:

- Lidhja midis tregut të punës dhe reformave të pensionit, ku u diskutua nevoja për integrim në tregun e punës edhe të moshave më të vjetra, kjo për të përballuar më mirë sfidat me të cilat po përballen sistemet e pensionit;
- E ardhmja e sistemeve të pensionit, ku nga një studim i prezantuar në seminar rezultoi që në vendet me të drejta të pensionit më të dobëta ka një tendencë që planet DB (*Defined Benefit*) të kthehen në DC (*Defined Contribution*);
- Praktikatat më të mira për hartimin e pensioneve;
- Ndikimi i ndryshimeve demografike tek oferta e punës dhe rritja ekonomike;
- Heqja e anuizimit të detyrueshëm në Angli.

Në përfundim të seminarit u theksua roli i kërkimit në mbështetje të proceseve politike dhe reformave.

○○○

Forumi u fokusua në dy tema kryesore, si edhe në të dhënat statistikore në lidhje me biznesin e sigurimit të pronës në tregjet vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore dhe si edhe ish Republikat e Bashkimit Sovjetik (vendet e CEE, SEE dhe CIS).

○○○

Zhvillohet forumi ndërkombëtar i sigurimeve “Sigurimi i pronës: Sfida e sigurimit nga katastrofat natyrore”

Në 26 qershor, në Mynih, Gjermani, u zhvillua edicioni i tretë i Forumit Ndërkombëtar të Sigurimeve me temë “Sigurimi i pronës: Sfida e sigurimit nga katastrofat natyrore”. Forumi u organizua nga *NTT Data*, një kompani e inovacionit teknologjik në botë. Në këtë forum morën pjesë përfaqësues të autoriteteve rregullatore dhe industrisë së sigurimeve, të cilët diskutuan mbi sigurimin nga katastrofat natyrore.

Forumi u fokusua në dy tema kryesore, si edhe në të dhënat statistikore në lidhje me biznesin e sigurimit të pronës në tregjet vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore dhe si edhe ish Republikat e Bashkimit Sovjetik (vendet e CEE, SEE dhe CIS). Tematikat kryesore të diskutuara në Forum ishin:

- Zgjidhjet më të përshtatshme për të ulur hendekun e sigurimit të pronës (*Insurance gap*), duke marrë parasysh mësimet e nxjerra nga ngjarjet më të fundit të katastrofave natyrore në botë;
- Roli që luan përparimi teknologjik, si në përmirësimin e procesit të marrjes në sigurim të kontratave për katastrofat natyrore, (*NatCat*), ashtu edhe në ristrukturimin e menaxhimit të dëmeve të ndodhura nga këto ngjarje.

Ekspertët u ndalën edhe në katastrofat e krijuara nga njeriu gjatë viteve të fundit, përfshirë edhe terrorizmin, si dhe krahësimin e tyre me katastrofat natyrore. Në vijim të Forumit, u prezantuan edhe modele të ndryshme të mbulimit nga rreziku i katastrofave sipas përvojave të vendeve të ndryshme si:

- Modeli i ndjekur nga Gjermania, e cila vendosi të mos ketë një sigurim të detyrueshëm të pronave nga katastrofat dhe shteti zgjodhi të japë një mesazh të qartë për publikun: “Banesat e pasiguruara nuk do të kompensohen nga shteti në rast të një fatkeqësie, përveçse kur pronari mund të provojë se ka kërkuar mbulimin dhe nuk ka qenë në gjendje ta marrë atë nga ofruesit e sigurimeve”;
- Funkionimi dhe problematikat e evidentuara nga Turqia në eksperiencën e saj të ndërtimit të skemës së llojit *Pool* për sigurimin nga katastrofat në nivel vendi;
- Një platformë online, nga përfaqësues të shoqërisë risiguruese Munich Re, për analizimin e të dhënave që lidhen me dëmet e katastrofave natyrore, *NatCatSERVICE*, i cili u lançua dy muaj më parë. Përdoruesi mund të zgjedhë llojet e rrezikut, zonën gjeografike dhe gjithashtu të përdorë informacionin lidhur me profilin social-ekonomik të vendit, si një filtër për të nxjerrë raporte të ndryshme.

Gjatë forumit u diskutua gjerësisht dhe roli i dixhitalizimit në industrinë e sigurimeve. Kështu, kompanitë e sigurimeve, sipas një studimi të *NTT DATA*, vlerësojnë se 40% e konsumatorëve janë të mërzhitur nga mungesa e shërbimeve *online*. Gjithashtu, 33% e kompanive të sigurimeve konsiderojnë "e-mail"-in si rrugën më të zakonshme të komunikimit dixhital, për kërkesa të thjeshta.

Një temë tjetër e trajtuar nga ekspertët e fushës ishte edhe ruajtja e të dhënave personale dhe përdorimi i tyre nga shoqëritë e sigurimit, konsumatorëve dhe enteve rregullatore drejt përmirësimit në këtë drejtim.

Metamorfoza e Greqisë dhe roli i industrisë së sigurimeve – Kujdestarët e së ardhmes?

Fjala e Z. Yannis Stournaras, Guvernator i Bankës së Greqisë, mbajtur gjatë Forumit të Parë mbi Sigurimet organizuar nga “Ekonomisti” në Athinë, më 30 mars 2017

(Marrë me shkurtime dhe redaktime – pjesa e tretë dhe e fundit)

Gjatë shtatë viteve të fundit, Greqia ka pësuar një ndryshim të thellë në formë, sikurse e përshkruan edhe fjala greke “metamorfoza”. Politikat e zbatuara në vitin 2010, në kuadër të tri programeve të rregullimit kanë ndihmuar në përballimin e mungesës së ekuilibrave të mëdha fiskale dhe ato të jashtme, duke e kthyer deficitin dyshifror në një bilanc pozitiv gjatë viteve të fundit. Krahas kësaj performance janë arritur përmirësime të konsiderueshme strukturore në tregjet e punës dhe të produkteve, si edhe në administratën publike.

Sidoqoftë, metamorfoza nuk është e plotë. Greqia nuk ka qenë ende në gjendje të kthehet në një rritje të qëndrueshme dhe një parakusht për këtë është përfundimi i shqyrtimit dhe zbatimi i vendosur i programit. Kjo është sfida aktuale, e cila e bën zbatimin e reformave strukturore të vështira dhe here pas here duke çuar në ndryshimin e politikave.

Vuajtja e gjatë e sistemit grek të pensioneve është një shembull kryesor në këtë aspekt. Që prej vitit 2010 janë zbatuar të paktën tre reforma të rëndësishme, por shumë dispozita mbeten ende për t'u zbatuar plotësisht, ndërsa sistemi mbetet i shtrenjtë, i deformuar dhe i padrejtë.

Pjesa e tretë e sistemit të sigurisë financiare të pensioneve lidhet me shtyllën e tretë të produkteve të pensioneve personale. Bashkimi Evropian, që prej vitit 2012, ka filluar një debat për zhvillimin e një tregu të brendshëm të BE-së për skemat apo produktet e pensioneve personale. Aktualisht, debati është intensifikuar duke u përqendruar te zhvillimi më tej edhe me përfshirjen aktive të EIOPA-s. Debati lidhet me të ashtuquajturin “Produktet e Pensioneve Personale gjithë-evropiane” (*Pan-evropan personal pension product, PEPP*). Për fat të keq, ky është një sektor ku Greqia nuk ka progres të konsiderueshëm, pasi i mungon kuadri ligjor përkatës. Unë jam i bindur se qytetarët grekë do të përfitojnë nga aplikimi i një kuadri të thjeshtë tatimor për pensionet personale, duke lejuar një reduktim të strukturave të kostos që do të menaxhohen duke përdorur mjete moderne dhe të fuqishme për menaxhimin e riskut. Transparenca e plotë e anëtarëve dhe përfituesve duhet të konsiderohet si një parakusht. Së fundmi, ekonomia greke do të përfitojë në tërësi, pasi këto produkte mund të përqendrohen në investime afatgjata, duke kontribuar kështu në rritjen ekonomike të qëndrueshme. Mendoj se perioda në vazhdim do të jetë shumë kritike për projektimin efikas të këtij sistemi, pasi është e lidhur me debatin aktual në nivel të BE-së siç e përmenda më sipër.

Por sipërmarrjet e sigurimeve nuk janë aktive vetëm në sektorin e pensioneve.

Një tjetër fushë delikate që lidhet me shërbimet e kompanive të sigurimit dhe ku ka pasur transformime të mëdha gjatë viteve të fundit, është sistemi grek i kujdesit shëndetësor. Të gjitha sistemet moderne të kujdesit shëndetësor kanë

Bashkimi Evropian, që prej vitit 2012, ka filluar një debat për zhvillimin e një tregu të brendshëm të BE-së për skemat apo produktet e pensioneve personale.

një qëllim të përbashkët: shpresën për një jetë të plotë dhe të shëndetshme, për ata që janë në varësi të këtyre shërbimeve.

Megjithatë, nuk është realiste, – e madje është e pamundur – të synosh të sigurosh "mundësimin e kujdesit shëndetësor të plotë për të gjithë". Kjo ndodh jo vetëm për shkak të rritjes potenciale të shërbimeve të kujdesit shëndetësor në mbarë botën, por edhe për shkak se rritja e kostove të sigurimit të këtyre shërbimeve ndaj çdo individ ka një rritje më të shpejtë sesa rritja ekonomike. Në këtë drejtim, gjithnjë e më tepër, qeveritë po cekin limitet financiare për shërbimet që ata mund të përballojnë.

Përderisa financimet publike të sistemit shëndetësor janë të detyruar të kontraktojnë për arritjen e këtyre shërbimeve dhe për rrjedhojë nuk janë në gjendje të ofrojnë shërbime të plota për të gjithë, atëherë pritet që sektori privat të luajë një rol të rëndësishëm në përmbushjen e kërkesës për kujdesin shëndetësor të qytetarëve.

Përderisa financimet publike të sistemit shëndetësor janë të detyruar të kontraktojnë për arritjen e këtyre shërbimeve dhe për rrjedhojë nuk janë në gjendje të ofrojnë shërbime të plota për të gjithë, atëherë pritet që sektori privat të luajë një rol të rëndësishëm në përmbushjen e kërkesës për kujdesin shëndetësor të qytetarëve. Nëse prioriteti i parë "është ofrimi shërbimeve për të gjithë, atëherë jo të gjitha shërbimet e kujdesit shëndetësor mund të sigurohen. Një standard i pranueshëm, por jo i plotë, duhet të bëjë dallimin midis "nevojave" të kujdesit mjekësor për qytetarët, në mënyrë që të arrihen rezultate të klasit të lartë dhe nga ana tjetër "të dëshirave" mjekësore dhe jo-mjekësore, të cilat, ndërkohë që vlerësohet nga pacientët, kontribuojnë vetëm tërthorazi në shëndetin e popullsisë. Pikërisht në këto rrethana sigurimi privat mund të luajë një rol të rëndësishëm në sistemin shëndetësor.

Projektimi i një sistemi të kujdesit shëndetësor kërkon në mënyrë të pashmangshme një zgjidhje midis të dy sistemeve ose përzierje midis qasjes publike dhe asaj private, veçanërisht në aspektin e financimit. Unë jam i bindur se qytetarët grekë mund të përfitojnë nga aplikimi i një sistemi grek të kujdesit shëndetësor publik universal i cili mbulon nevojat e popullsisë dhe gjithashtu jep fonde dhe mbulon disa "dëshira" të popullsisë me një sistem të rregulluar në mënyrë të përshtatshme sipas një tregu të sigurimit shëndetësor privat. Në këtë kontekst, nëse do të arrijmë një konsensus për sistemin shëndetësor me dy nivele, hapi tjetër do të jetë dakordimi për të bërë ndryshimin midis "nevojave" dhe "dëshirave".

Sigurisht, ne nuk duhet të harrojmë se tregjet private të sigurimit janë karakterizuar nga asimetria e informacionit, se blerësit (konsumatorët) dinë më tepër rreth rreziqeve të tyre, sesa shitësit e produkteve (kompanitë e sigurimeve).

Përgjithësisht ka dy mënyra alternative për të kapërcyer këto të meta të tregut. Qasja e parë lidhet me pjesëmarrjen vullnetare në këto skema dhe u mundëson kompanive të sigurimeve të përballen me karakteristikat e përmendura si më lart, ndoshta duke zbatuar praktika më agresive të menaxhimit të riskut (p.sh. procesi i rreptë i procedurave të përzgjedhjes ose vendimet mbi rritjen e përçindjeve). Sipas qasjes së dytë, pjesëmarrja në skema është e detyrueshme: kur e gjithë popullsia është përfshirë në grupin e riskut, atëherë pasiguria në lidhje me nivelin e riskut të shkaktuar nga zgjedhja eliminohet tërësisht.

Historikisht, për shkak të niveleve të ulëta të penetrimit të sigurimeve në Greqi, kostoja e dëmeve bartet nga qytetarët të cilët pësojnë humbje dhe dëmshpërblimi i të cilëve varet kryesisht nga politikat dhe mbi të gjitha nga fondet e vëna në dizpozicion nga buxheti i qeverisë.

Sigurisht, nëse zgjedhja do të ishte një treg i detyrueshëm i sigurimeve shëndetësore private, atëherë ligjet dhe rregulloret duhet të drejtohen drejt minimizimit dhe kompensimit të përshtatshëm për aspektet e mbetura të përzgjedhjes së risqeve, vlerësimit e renditjes së risqeve dhe rinovimit të menaxhimit të risqeve që bien ndesh me funksionimin e duhur të sistemit universal të sigurimit shëndetësor.

Si çështja e fundit, por jo më pak e rëndësishme, do të doja t'i referohem fatkeqësive natyrore.

Klima e Greqisë mund të karakterizohet si mesdhetare, me dimër të butë, me reshje lokale e të rrëmbyeshëm dhe verë të thatë. Për më tepër, Greqia është vendi që gjigandi legjendar Enceladus e trondit shumë shpesh. Të tre këto situata përbëjnë rreziqe fizike që intensifikojnë rreziqet e përmbytjeve, zjarreve dhe tërmeteve. Për fat të mirë këto rreziqe nuk materializohen shpesh, por kur e bëjnë një gjë të tillë, ato kanë për tendencë të krijojnë dëme katastrofike.

Historikisht, për shkak të niveleve të ulëta të penetrimit të sigurimeve në Greqi, kostoja e dëmeve bartet nga qytetarët të cilët pësojnë humbje dhe dëmshpërblimi i të cilëve varet kryesisht nga politikat dhe mbi të gjitha nga fondet e vëna në dizpozicion nga buxheti i qeverisë. Pa dyshim, shteti duhet të kujdeset për mbrojtjen e qytetarëve të tij. Por marrja nën mbrojtje e qytetarëve të tij, duhet të ushtrohen në mënyrë të tillë që të mbrojnë taksapaguesit. Një nga mënyrat më efektive për të arritur këtë qëllim është krijimi i një tregu sigurimesh të detyrueshme private, të rregulluar në mënyrë të përshtatshme për përballimin e risqeve.

Në përfundim, dëshiroj të theksoj, se çështjet e përmendura më lart – pensionet, kujdesi shëndetësor dhe fatkeqësitë natyrore – përbëjnë çështje shumë delikate për politikëbërësit (hartuesit e politikave). Por siç kam vënë në dukje, gjatë fjalës sime, këto janë zonat që do të përfitojnë nga sinergjitë e sektorit publik dhe atij privat, pavarësisht karakteristikave të tyre të veçanta. Megjithatë, ky bashkëpunim nuk duhet të varet nga objektivat afatshkurtra të secilës qeveri, por përkundrazi, duhet të jetë pjesë e politikave kombëtare të projektuara me një perspektivë afatgjatë. Gjithashtu, është e domosdoshme, që kushtet e këtij bashkëpunimi duhet të jenë të qarta dhe transparente për të gjithë pjesëmarrësit e anëtarët dhe përfituesit e çdo sistemi.

Bosnje-Hercegovinë

www.xprimm.com

<http://www.ebrd.com/news/2017/ebd-pioneers-private-pension-management-in-bosnia-and-herzegovina.html>

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, BERZH, bëhet nismëtare për zhvillimin e menaxhimit të pensioneve private në Bosnje-Hercegovinë. BERZH investoi në kapitalin e kompanisë menaxhuese të Fondit Vullnetar Evropian të Pensioneve së bashku me një kompani sllovene dhe Fondin Rezervë të Pensioneve të Republikës Serbe të Bosnjës.

BERZH dhe Fondi i Zgjerimit të Ndërmarrjeve (ENEF) do të investojnë së bashku rreth 742,500 euro, për të blerë 33% të kapitalit dhe të drejtës së votimit në shoqërinë aksionare.

Përmes këtij investimi, EPF, Fondi Vullnetar Evropian i Pensioneve, do të jetë ofruesi i parë i pensioneve private vullnetare në Republikën Serbe të Bosnjës, njëra nga dy entitetet përbërëse të Bosnje-Hercegovinës. Kjo do t'u ofrojë klientëve privatë dhe investitorëve mundësi të gjera zgjedhjesh, duke përfaqësuar një arritje madhore në zhvillimin e tregut lokal të kapitaleve.

Zhvillimi i tregjeve lokale të kapitaleve vlerësohet si një nga prioritetet strategjike të BERZH-it. Drejtori për Ballkanin Perëndimor në BERZH, duke vlerësuar me krenari këtë investim theksoi se "... Reforma në sistemin e pensioneve dhe zhvillimi i kompanive të menaxhimit të pensioneve private janë sfida dhe njëkohësisht hapa të rëndësishëm për vendet në proceset e tyre ekonomike të tranzicionit. Menaxhimi i pensioneve private është mjaft i ndjeshëm dhe do të duhet të bëhet me shumë kujdes. Investimi ynë në menaxhimin e sistemit të pensioneve tregon për besimin tonë se kjo është çfarë kompania do të bëjë për të mirën e klientëve dhe të tregut".

Çeki

www.xprimm.com

Sipas të dhënave nga faqja e Internetit të Bankës Kombëtare të Çekisë, industria lokale e sigurimeve në fund të vitit 2016 arriti rreth 147.22 miliardë CZK (Korona Çeke, monedha e vendit) ose rreth 5.45 miliardë euro. Këto të dhëna, të publikuara nga Banka Kombëtare e Çekisë, përfshijnë rezultatet si për siguruesit vendas, ashtu edhe për degët e kompanive të huaja.

Vlera e primeve të shkruara bruto për sigurimin e Jetës (përfshirë edhe risigurimin) ishte 59.59 miliardë CZK, ose 2.2 miliardë euro. Numri i policave aktive të sigurimit arriti 5,996,463, ndërsa numri i policave të reja ishte 683,509.

Për tregun e sigurimit të Jo-Jetës, volumi i primeve të shkruara bruto arriti në 87.62 miliardë CZK, ose rreth 3.23 miliardë euro, me 20,865,156 polica të reja dhe 10,454,332 polica.

Estoni

www.xprimm.com

Sipas shifrave tremujore të publikuara nga Bordi Kombëtar i Statistikave të Estonisë, tregu i sigurimeve, për tremujorin e parë të vitit 2017, raportoi një volum të primeve të shkruara bruto prej 99.7 milionë euro, duke pasqyruar kështu një rritje me 8.6% në terma vjetore. Në tregun e sigurimeve të Jetës, vlera e përgjithshme e primeve të shkruara bruto u rrit me 3.6% duke arritur në 19.7 milionë euro. Këto shifra pasqyrojnë performancën e siguruesve estonezë dhe degëve të tjera të kompanive të sigurimit të BE-së, vetëm për rreziqet e siguruar në Estoni.

Greqi

www.xprimm.com

Sipas shifrave paraprake të publikuara nga Shoqata Greke e Kompanive të Sigurimeve (*Hellenic Association of Insurance Companies, HAIC*), në fund të marsit 2017, tregu grek i sigurimeve arriti në 962 milionë euro, duke u rritur me 1.4% në terma vjetorë. Rezultatet paraprake të tregut, të botuara nga HAIC, përfshijnë shifrat për 50 kompanitë e sigurimeve që përbëjnë 97.2% të të dhënave të plota të tregut të sigurimeve.

Tregu i sigurimit të Jetës u rrit me 3.5% në terma vjetorë, duke arritur në 321 milionë euro. Kjo rritje kishte si shkak rritjen vjetore prej 65% të raportuar në produktet e lidhura me skemat e investimeve. Ndërsa tregu i sigurimeve të Jo-Jetës ra me 0.6% duke arritur në 473 milionë euro. Në sigurimet e Jo-Jetës, sigurimet e pronës ranë me 1% dhe sigurimet motorike ranë me 3%, duke pasur kështu influencën më të madhe në rezultatet e këtij tregu.

Sllovaki

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të publikuara nga Banka Qendrore e Sllovakisë, në fund të vitit 2016, tregu i sigurimeve në vend pësoi rënie të primeve të shkruara bruto me 1.78% duke arritur në 1.98 miliardë euro.

Rënia u shkaktua kryesisht në sigurimin e Jetës, i cili u ul me 8.95%, krahasuar me një vit më parë, duke arritur në 960 milionë euro, nga 1.05 miliardë euro që ishte në fund të dhjetorit 2015.

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto në sigurimet e Jo-Jetës u rritën me 6.04% duke arritur në 1.02 miliardë euro. Sigurimet e Jo-Jetës zënë rreth 51.6% të tregut në total.

Pas tërmetit të vitit 2016, Shoqata e Italiane e Siguruesve (*ANIA-the Italian Insurers' Association*) po punon në një projekt mbi sigurimin familjar ndaj rreziqeve të katastrofave. Marina Bianca Farina, Presidente e ANIA, për Italinë theksoi domosdoshmërinë e një zgjidhjeje për menaxhimin më të mirë të rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore. Kjo duhet të lidhet edhe me partneritetin publik-privat. Duke folur për publikimin online *Xprimm* Presidenti Farina tha "... Zgjidhja mund të jetë një sigurim i detyrueshëm për të gjithë pronarët e shtëpive, duke siguruar çmime të përballueshme dhe duke respektuar ndryshimet midis zonave të territorit". Projekti konsideron faktin se tregu i sigurimeve mund të mbulojë pjesën më të madhe të rreziqeve nga tërmetet, "duke kërkuar ndërhyrjen e shtetit për të mbuluar vetëm ngjarjet e mundshme dhe shumë të rënda që tejkalojnë kapacitetin e sistemit të sigurimeve".

Megjithatë, projekti është ende në fillimet e tij dhe kërkon një konsultim të gjerë me organizmat publikë dhe aktorë të tjerë. Ai nevojitet të përshtatet me projektet kombëtare të forcimit sizmik të ndërtesave dhe edukimit të qytetarëve në lidhje me rrezikun nga katastrofat natyrore. Një pikë e mirë nisjeje mund të jetë përfshirja për ndërtesat që do të rindërtohen pas tërmetit të vitit 2016 ose ato të përfshira në planin kombëtar "*Casa Italia*".

Ideja e një forme sigurimi të detyrueshëm të shtëpive nuk ka dalë tani për herë të parë. Ajo është diskutuar edhe pas tërmetit që goditi Italinë qendrore vite më parë.

Italia, me vendndodhjen e saj gjeologjike, ka një histori të gjatë të tërmeteve të fuqishme në të gjithë vendin dhe veçanërisht në rajonin e Apenineve Qendrore. Tërmetet e fuqishme ishin të shumta në historinë e vendit. Sipas *Standard & Poor*, Italia është vendi i dytë në Evropë, më i prirur nga tërmeti, pas Turqisë. Përveç kësaj, vendi është i prirur për katastrofa të tilla si përmbytjet, rrëshqitjet e dheut, tërmetet dhe tornadot.

Në vitet e kaluara kanë dështuar disa përpjekje për vendosjen e sigurimit të detyrueshëm të shtëpive të promovuara nga qeveria, pasi ato u refuzuan nga Parlamenti.

Në Itali, rreth 70% e fondit të banesave gjendet në zonat më të rrezikuara nga tërmeti, të cilat kërkojnë sigurimin e pronës, veçanërisht për mbulimin e katastrofave natyrore. Sigurimi i ndërtesave italiane nuk mbulon dëmet nga tërmeti, përveç rasteve kur kërkohet në mënyrë specifike nga i siguruari. Çmimet e sigurimeve janë të larta, procedurat janë mjaft të komplikuar dhe ndërtesat kanë nevojë për një vlerësim profesional të rreziqeve. Për këtë arsye, ekziston një mbështetje e madhe në ndërhyrjen e qeverisë pas ndodhjes së katastrofave. Sipas *Swiss Re*, treguesi i penetrimit të sigurimit komercial të tërmeteve ishte në nivelin 0.07% në vitin 2014. Ndërsa për ngjashmëri, treguesi i penetrimit të sigurimit rezidencial të tërmeteve ishte 0.01%. Kjo ishte për shkak të ndërhyrjes dhe mbështetjes së qeverisë pas fatkeqësive natyrore.



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al